



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME**

**PLANI I MASAVE PËR PËRMBUSHJEN E PËRPARËSIVE TË PËRCAKTUARA NGA  
KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN**

**21 shtator 2020**

## **Hyrje**

### **Hapja e negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian**

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian është objektivi strategjik i Shqipërisë, që qëndron në thelb të politikës së brendshme dhe të jashtme. Programi i qeverisë 2017–2021 synon fillimin, sa më parë, të procesit të negociatave për anëtarësim. Negociatat e anëtarësimit përbëjnë një proces me rëndësi strategjike kombëtare për Shqipërinë, si një vend që synon konsolidimin e demokracisë, e respektimit të parimeve të shtetit të së drejtës, të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të dialogut politik, të transparencës, të gjithëpërfshirjes dhe të ekonomisë funksionale të tregut, të cilat përbëjnë vlerat e përbashkëta mbi të cilat është themeluar Bashkimi Evropian. Përparimi në procesin e negociatave të anëtarësimit bazohet në hartimin dhe zbatimin e reformave transformuese dhe të pakthyeshme.

Më 25 mars 2020, Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme i Bashkimit Evropian vendosi që të hapë negociatat e anëtarësimit me Shqipërinë, bazuar në progresin e arritur në reformat dhe përmbushjen e kushteve të përcaktuara në unanimitet nga Këshilli i qershorit 2018. Më 26 mars 2020, Këshilli Evropian miratoi vendimin e Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme të BE-së për hapjen e negociatave me Shqipërinë. Ky vendim i Bashkimit Evropian është sinjal politik tejet i rëndësishëm për Shqipërinë, që tregon se vendi po ecën në drejtimin e duhur, përmes reformave të vështira, por të domosdoshme. Qeveria dhe të gjithë institucionet shtetërore duhet të konsolidojnë reformat e arritura dhe të thellojnë më tej reformat për plotësimin e përparësive të procesit të integritimit evropian. Pas vendimit pozitiv për nisjen e bisedimeve të anëtarësimit të Shqipërisë, hapi tjetër madhor që presim të ndërmarrim është organizimi i Konferencës së Parë Ndërqeveritare, e cila shënon hapin e parë politik të negociatave të anëtarësimit.

### **Plani i Masave për përmbushjen e përparësive të përcaktuara nga Këshilli i BE-së**

Plani vendos masat do të merren nga institucionet shtetërore për përmbushjen e përparësive që përcaktoi Këshilli i 25 marsit 2020. Ky Këshill vendosi që Konferenca e parë Ndërqeveritare të mbahet sa më shpejt pas miratimit të kornizës së negociatave nga Këshilli dhe që deri atëherë, Shqipëria duhet të ketë miratuar reformën zgjedhore në përputhje me rekomandimet e OSBE/ODHIR, duke siguruar financim transparent të partive politike dhe fushatave elektorale; të ketë siguruar vijimin e zbatimit të reformës në drejtësi, përfshirë sigurimin e funksionimit të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, duke marrë parasysh ekspertizën përkatëse ndërkombëtare, përfshirë opinionet përkatëse të Komisionit të Venecias; të ketë përfunduar ngritjen e strukturave të specializuara kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar; të forcojë më tej luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, edhe nëpërmjet bashkëpunimit me shtetet

anëtare të BE-së dhe përmes plan veprimit për të adresuar rekomandimet e Task Forcës të Veprimit Financiar (FATF).

Këshilli i 25 marsit 2020 përcaktoi edhe përparësi të tjera të rëndësishme, si dhe përparësitë që duhet të përmbajë Korniza e Negocimit, e cila do t'i paraqitet Shqipërisë në Konferencën e parë Ndërqeveritare.

Për secilën nga këto përparësi, Planit përcakton masa konkrete, duke ngarkuar institucionet përgjegjëse për zbatimin e tyre, sipas afateve të vendosura në Plan. Kësisoj, Planit ngrihet mbi prioritetet e vendimit të marsit 2020, të cilat janë shumë të rëndësishme, si në aspektin e përparimit në hapin e radhës së procesit, Konferencën e parë Ndërqeveritare, ashtu edhe përgjatë procesit të negociatave. Ky Plan angazhon institucionet më të larta të shtetit. Ai miratohet nga Kuvendi, bazuar në rolin parësor të Kuvendit në përmbushjen e detyrimeve të procesit të integritetit dhe në monitorimin e aktivitetit të strukturave shtetërore në lidhje me integrimin evropian, duke shërbyer edhe si urë lidhëse mes aktorëve të përfshirë.

#### *Procesi i konsultimit*

Duke qenë se masat e Planit të Veprimit përfshijnë një numër të konsiderueshëm institucionesh të larta shtetërore, Planit u diskutua, më 9 qershor 2020, në një mbledhje të zgjeruar të Këshillit Kombëtar të Integritetit Europian, me pjesëmarrje të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, përfaqësuesve të institucioneve të sistemit të drejtësisë, etj. Ky diskutim u bazua jo vetëm në rëndësinë e Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian si organizëm gjithëpërfshirës konsultativ për integrimin evropian, por edhe në nevojën për një Plan Veprimi jo vetëm të qeverisë, por mbarëkombëtar e ndër-institucional, me një mbështetje të fortë politike e vullnet të padiskutueshëm për plotësimin e masave brenda afateve të vendosura në plan.

Sugjerimet e paraqitura gjatë takimit të Këshillit Kombëtar të Integritetit dhe ato të paraqitura me shkrim nga institucioni i Presidentit të Republikës, Këshilli i Lartë të Prokurorisë, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit janë marrë parasysh gjerësisht në formën përfundimtare të Planit të Veprimit.

#### *Monitorimi i zbatimit të Planit të Veprimit*

Kuvendi do të monitorojë zbatimin e Planit të Veprimit, duke forcuar më tej veprimtarinë e organeve nëpërmjet të cilave Kuvendi ushtron përgjegjësinë e tij në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Europian, si Komisioni për Integritetin Europian dhe Këshilli Kombëtar për Integrimin Europian, me qëllim forcimin e dialogut gjithëpërfshirës dhe rritjen e transparencës në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Europian. Ky monitorim do të bazohet në raportimin periodik nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e masave të Planit.

## Përparësi për t'u përmbushur deri në Konferencën e Parë Ndërqeveritare

Nr.	Prioriteti	Masat	Hapat	Institucionet e Përfshira	Afatet
1	<b>Miratimi i reformës zgjedhore</b>	Miratimi i reformës zgjedhore (përfshirë financimin e fushatave elektorale) në përputhje të plotë me rekomandimet e OSBE/ODIHR duke siguruar financim transparent të partive politike dhe fushatave zgjedhore	1. Miratimi i ndryshimeve të Kodit Zgjedhor në përputhje me rekomandimet e OSBE/ODIHR  2. Miratimi në Parlament i ligjit të posacëm për financimin e partive politike	Kuvendi (Këshilli Politik)	1.Realizuar  2.Tetor 2020
2	<b>Sigurimi i Vazhdimësisë së zbatimit të Reformës në Drejtësi duke marrë në konsideratë ekspertizën ndërkombëtare përkatëse përfshirë opinionet e Komisionit të Venecias</b>  2/a. sigurimi i funksionimit të Gjykatës		1. Përfundimi nga KED i të gjithë procesit të verifikimit dhe pikëzimit për kandidatët e	Këshilli i Emërimeve në	Afatet për

	<b>Kushtetuese</b>	a. Emërimi i së paku 6 anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese:	<p>vakancës së shpallur nga Presidenti i Republikës në datë 22.11.2019;</p> <p>2. Emërimi i kandidatit nga Presidenti i Republikës nga lista e tre kandidatëve të dërguar nga KED;</p> <p>3. Përfundimi i procedurës së verifikimit të kandidatëve për dy vakancat e parakohshme, të shpallura respektivisht nga Presidenti i Republikës dhe Kuvendi dhe rishpallja e vendeve vakante, nëse vendimmarrja e KED nuk rezulton me kandidatë të kualifikuar sipas parashikimeve ligjore;</p> <p>4. Emërimi i dy gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese me mandat deri në vitin 2022, respektivisht nga Presidenti i Republikës dhe Kuvendi.</p>	Drejtësi; Presidenti i Republikës; Kuvendi	<p>përfundimin e hapave 1 dhe 2: Nëntor 2020</p> <p>Afati për përfundimin e hapave 3 dhe 4: Dhjetor 2020</p>
2/ b	<b>sigurimi i funksionimit të Gjykatës së Lartë</b>	Emërimi i gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë	1. Kryerja e të gjitha procedurave për verifikimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve për 12 vendet vakande të shpallura nga KLGJ, specifikisht;	KLJG	<p>Afati</p> <p>3 mujori i parë i 2021</p>

3	<p><b>Finalizimi i ngritjes se strukturave kundër krimit dhe anti-korrupsionit/ Funksionimi i SPAK</b></p>	<p>1. Plotësimi i SPAK me 15 prokurorë</p> <p>2. Plotësimi i strukturës së Byrosë Kombëtare të Hetimeve (BKH)</p>	<p>1. Vijim i procedurave për emërimin e 2 anëtarëve të tjerë të SPAK;</p> <p>2. Përshpejtim i procedurave të rivlerësimit për dy kandidatët për anëtarë të SPAK;</p> <p>3. përfundimi i rikonstruksionit të mjediseve të SPAK;</p> <p>4. miratimi i ndryshimeve ligjore në lidhje me përcaktimin e plotë të pagës (pagesa për vështirësi) për të gjithë punonjësit e SPAK</p> <p>Realizuar nëpërmjet miratimit në Parlament të Ligjit nr. 15/2020 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 96/2016, për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërise', të ndryshuar"</p> <p>4. Fillimi i procesit të përzgjedhjes së Drejtorit dhe 60 kandidatëve për hetues të BKH dhe shqyrtimi i kandidaturave.</p> <p>KLP miratoi në mbledhjen e datës 30.07.2020, Vendimin nr. 183 "Për emërimin e Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit", Znj. Aida Veizaj u emërua Drejtor i Byrosë Kombëtare të Hetimit, me një mandat 5-vjeçar, duke filluar funksionet më datë 01.09.2020</p>	<p>KLP, SPAK, BKH, KPK, KPA, KP</p>	<p>Afati</p> <p>dhjetor 2020</p>
---	--	---	---	-------------------------------------	----------------------------------

4	<p><b>Forcimi i mëtejshëm i luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar përfshirë bashkëpunimi me vendet anëtare të BE-së dhe nëpërmjet Plan Veprimit në përgjigje të rekomandimeve të FATF (Financial Action Task Force)</b></p>	<p>1. Zbatimi i Ligjit Normativ të datës 31.01.2020 për “Masat parandaluese për forcimin e luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimin e rendit publik”</p> <p>2. Zbatimi i planit të veprimit 2019-2020, në përputhje me Strategjinë Ndërsektoriale për Luftën kundër Krimit të Organizuar, Trafikimit të Paligjshëm dhe Terrorizmit, miratuar me VKM Nr. 616, datë 18.09.2019</p> <p>3. Analizë mbi kërcënimet dhe dobësitë e PP-së për sektorët/produktet specifik, me theks të veçantë në pasuritë e paluajtshme, agjentët e pasurive të paluajtshme, avokatët, kontabilistët, dhe keqpërdorimin e llojeve të ndryshme të personave juridik (Pika 1.1 e 'Immediate Outcome 1' të Rekomandimeve të FATF)</p> <p>4. Realizimi i një plani unik të koordinuar për mangësitë që kanë rezultuar nga Vlerësimi kombëtar i riskut për PP/FT dhe çfarë do të rezultojë nga analizat e mësipërme (Pika 1.2 e 'Immediate Outcome 1' të Rekomandimeve të FATF)</p> <p>5. “Projekti Fiskalizimit” për trajtimin e ekonomisë joformale dhe zvogëlimin e përdorimit të parasë fizike</p>	<p>1. Vazhdimi i veprimtarisë së Operacionit Forca e Ligjit (OFL), duke rritur numrin e çështjeve të dërguara në SPAK.</p> <p>2. Forcimi i kapaciteteve hetimore të Policisë së Shtetit duke krijuar tre njësi speciale në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit: a) njësinë e hetimit të krimit ekonomik, Njësia E b) njësinë e inteligjencës policore, Njësia 1 c) njësinë e krimit kibernetik, Njësia C</p> <p>3. Analiza e produkteve dhe shërbimeve bankare dhe rreziku që ata paraqesin në sistemin tonë bankar në drejtim të pastrimit të parave; (realizuar)</p> <p>4. Analiza e keqpërdorimit të llojeve të ndryshme të personave juridikë për pastrim parash; (realizuar)</p> <p>5. Analiza e rrezikut në lidhje me pasuritë e patundshme dhe agjentët e pasurive të paluajtshme në fushën e pastrimit të parave;</p> <p>6. Analiza e rrezikut të kontabilistëve në fushën e pastrimit të parave;</p> <p>7. Analiza e rrezikut të avokatëve në fushën e pastrimit të parave;</p> <p>8. Identifikimi i pikave të dobëta si rezultat i vlerësimit kombëtar të rrezikut, masave të propozuara për zbutjen e tyre dhe institucioneve përgjegjëse;</p> <p>9. Zbatimi nga GTD i modulit: "Implementimi i faturave me para në dorë për bizneset me qarkullim mbi 8 milion lekë</p>	<p>Qeveria,</p>	<p>Hapat 1 &amp; 2 Në vazhdim</p> <p>Hapat 5, 6, 7 &amp; 8 Shtator 2020</p> <p>Hapi 9 &amp; 10 Shtator 2021</p>
---	---	---	--	-----------------	---

		<p>6.Vënia në funksionim të një sistemi elektronik brenda Ministrisë së Drejtësisë për prioritizimin sistematik të letër-porosive</p> <p>7. Prezantimi i projekt-bazës ligjore për regjistrin qendror mbi pronësinë përfituese për personat juridikë dhe marrëveshjet ligjore pranë Këshillit të Ministrave në përputhje me shkëmbimin e letrave midis Zëvendës Presidentit të Komisionit Dombrovskis</p> <p>8. Miratimi i ligjit “Për profesionin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme”</p> <p>9. Miratimi i ligjit “Për organizatat jofitimprurëse”</p> <p>10. Funksionimi i sistemit elektronik për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse</p> <p>11. Funksionimi i sistemit për realizimin e prioritizimit sistematik të letër porosive</p>	<p>10. Trajnimi i stafit për përdorimin e sistemit elektronik.</p> <p>11. Miratimi i ligjit “Për profesionin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme”;</p> <p>12. Miratimi i ligjit “Për organizatat jofitimprurëse”;</p> <p>13. Koordinimi i punës për ngritjen e sistemit elektronik për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë;</p> <p>14. Koordinimi i punës midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme për realizimin e prioritizimit sistematik të letër porosive.</p>	<p>Kuvendi</p> <p>Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Prokuroria e Përgjithshme</p>	<p>Hapat 11&amp;12: nëntor 2020</p> <p>Hapat 13 &amp;14 në proces</p>
--	--	--	--	--	---



## Përparësi të rëndësishme

5	<p>Trajtimi i fenomenit të azilkërkuesve dhe sigurimi i riatdhesimit të shtetasve shqiptarë</p>	<p>Bashkëpunimi me Hollandën, Francën, Britaninë e Madhe, Gjermaninë, Italinë, Irlandën. Vazhdimi i Zbatimit të Planit Ndërinstitucional të Veprimit për parandalimin e azilkërkimit të qytetarëve shqiptarë në vendet e Schengen-it dhe marrja e masave që lidhen me riatdhesimin dhe ri-integrimin e të kthyerve</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Shkëmbimi i vazhdueshëm i informacionit për trendin e abuzimit me lëvizjen e lirë.</li> <li>2. Forcimi i shkëmbimit të informacionit me qëllim identifikimin e shtetasve shqiptarë me qëndrim të parregullt në hapësirën Schengen.</li> <li>3. Vazhdimi i operacioneve të kthimit të shtetasve shqiptar me qëndrim të parregullt në vendet anëtare të BE-së dhe në hapësirën Schengen.</li> <li>4. Hartimi i një kuadri ligjor efektiv në lidhje me parandalimin e fenomenit të azilkërkimit abuziv, duke parashikuar masa shtrënguese për të udhëtuar drejt vendeve të hapësirës Shengen të personave të shpallur INAD apo DEPORTIV.</li> <li>5. Intensifikimi i operacioneve, në bashkëpunim me FRONTEX--duke vendosur eskortë shqiptare në operacionet e kthimit të koordinuara nga FRONTEX-i.</li> <li>6. Implementimi i strategjisë Kombëtare për Migracionin</li> </ol>	<p>Qeveria</p>	<p>Hartimi i kornizës ligjore në lidhje me masat e reja parandaluese :</p> <p>Procesi në vazhdim</p>
---	---	--	---	----------------	--

6	<b>Amendimi i Ligjit të Medias në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venecias</b>	Rishikimi i ligjit bazuar në opinionin e Komisionit të Venecias, CDL-REF(2020)007-e	1. Reflektimi i Opinionit të Komisionit të Venecias CDL-REF(2020)007-e dhe miratimi i ndryshimeve ligjore në Kuvend.	Qeveria, Kuvendi	Dhjetor 2020
---	--	---	--	------------------	--------------

**Përparësi që pritet të reflektohen në Kornizën e Negocimit**

7	<b>Fillimi i Procedurave Penale kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve të akuzuar për sjellje kriminale gjatë procesit të vetingut</b>	Progres me proceset gjyqësore kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve të akuzuar për shkelje gjatë procesit të vetting	Identifikimi i rasteve dhe ndjekja për secilin rast	Institucionet e gjyqësorit	Në vazhdim
---	---	--	---	----------------------------	------------

8	<b>Fillimi i procedurave ndaj të akuzuarve për blerje vote</b>	Progres me hetimin/proceset gjyqësore kundër personave të akuzuar për blerje vo	Identifikimi i rasteve dhe ndjekja për secilin rast	Institucionet e gjyqësorit	Në vazhdim
9	<b>Track Records- Inicimi dhe përfundimi i proceseve gjyqësore të shkallës së parë të zyrtarëve të lartë dhe politikanve</b>	<p>1. SPAK dhe Gjykata e Posaçme të kenë raste të suksesshme të hetimit dhe gjykimit të zyrtarëve të lartë.</p> <p>2. Funkzionimi i Rrjetit Antikorrupsion të ngritur me urdhër të KM</p> <p>3. Koordinim ndër-istitucional dhe zbatim i plotë i Rekomandimeve të Raundit të Katërt të GRECO.</p> <p>4. Përgatitja për përfaqësim dhe raportim në Seancën e 1-rë Plenare të Roundit të 5-të të GRECO, me focus: “Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i integritetit në qeveritë qendrore (funksionet kryesore ekzekutive) dhe agjencitë e zbatimit të ligjit”.</p>	<p>1. Vijimi i punës nga SPAK dhe gjykatat e posaçme për hetimin dhe gjykimin e zyrtarëve të lartë;</p> <p>2. Lidhur me Rrjetin Antikorrupsion:</p> <p>2.1. Emërimi i anëtarëve e Rrjetit Antikorrupsion në institucionet që ofrojnë shërbime për qytetarët dhe bizneset;</p> <p>2.2 Hartimi i termave të referencës për një sistem elektronik të çështjeve antikorrupsion.</p> <p>2.3 Bashkëpunimi me Task Forcën për hetimin me sukses të rasteve të korrupsionit në administratën publike;</p> <p>3. Koordinimi nga Ministria e Drejtësisë e punës me Kuvendin, KLGJ, KLP, ILDKPKI për përmbushjen e Rekomandimeve të mbetura nga raundi i katërt i GRECO dhe mbrojtja e suksesshme në Seancën Plenare;</p> <p>4. Përgatitja dhe koordinim ndër-institucional për përfaqësim dhe mbrojtje në Seancën e 1-rë Plenare të Roundit të 5-të të GRECO me focus: “Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i integritetit në qeveritë qendrore (funksionet kryesore ekzekutive) dhe agjencitë e zbatimit të ligjit”.</p>	SPAK, gjykatat e posaçme, Ministria e Drejtësisë dhe institucionet përgjegjëse për raportim për GRECO	<p>Hapi 1: Në vazhdim</p> <p>Hapat 2 &amp; 3: dhjetor 2020</p> <p>Hapi 4: Në vazhdim</p>

10	<b>Progres në reformën e administratës publike</b>	<p>1. Përmirësim i mëtejshëm i procesit të rekrutimit dhe të zbatimit të vendimeve gjyqësore</p> <p>2. Ndërtimi i kapaciteteve dhe zbatimi i vlerësimeve të impaktit rregullator dhe buxhetor në të gjitha ministritë për të përmirësuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë financiare të propozimeve legislative dhe politikave</p> <p>3. Përafrimi i legjislacionin sektoral me Kodin e Procedurave Administrative (KPA)</p>	<p>1.1 Koordinimi periodik dhe raportimi me DoPA për zbatimin e masave. Krijimi i kushteve administrative-logjistike për zbatimin e vendimeve gjyqësore në administratën publike.</p> <p>2.1 Organizimi i trajnimit të vazhdueshëm me ministritë (7 seminare të planifikuara përmes Asistencës)</p> <p>2.2. Hartimi i 68 raporteve të RIA për projektligjet sipas planit analitik</p> <p>2.3. Përgatitja dhe miratimi i strategjisë "Rregullimi më i mirë";</p> <p>2.4 Kontrolli i cilësisë së raporteve në përputhje me kriteret e dakorduara me Delegacionin;</p> <p>2.5 Shqyrtimi dhe miratimi i kornizës metodologjike për vlerësimin e ndikimit rregullator;</p> <p>2.6. Përgatitja e analizave të ndikimit (me dhe pa vlerën monetare) në buxhetin e shtetit;</p> <p>3. Ndërmarrja e masave për inicimin dhe koordinimin e procesit të përafrimit të legjislacionit sektoral me Kodin e Procedurave Administrative</p>	Qeveria	Në vazhdim
11	<b>Zbatimi i reformës zgjedhore</b>	<p>1. Zbatimi i kuadrit ligjor për reformën zgjedhore</p> <p>2. Financimi transparent i partive</p> <p>3. Administrimi i paanshëm i procesit</p>		Qeveria / Administrata Zgjedhore / Partitë Politike	Deri në zgjedhjet e para të përgjithshme

12	<b>Vendimi për ligjshmërinë e zgjedhjeve lokale 2019</b>	Duhet plotësuar Gjykata Kushtetuese	Pasi Gjykata Kushtetuese të jetë në gjendje të miratojë vendime.	Gjykata Kushtetuese	Tremujori i 1 i 2021
13	<b>Miratimi i Akteve nënligjore të Ligjit për Pakicat Kombëtare</b>	<p>1. VKM e propozuar nga Ministria e Brendshme për përcaktimin e përbërjes, funksioneve dhe procedurave të Komisionit për të shqyrtuar kërkesat për njohje të minoriteteve</p> <p>2. VKM Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave përkatëse për mbledhjen e të dhënave për identifikimin e personave që i përkasin pakicave kombëtare, bazuar në të drejtën e vetë-identifikimit dhe të dokumentacionit në Regjistrin Civil.</p> <p>3. VKM-ja e MASR dhe MB mbi Kriteret për Përcaktimin e Njesisë së Pushtetit Lokal, numrin thelbësor dhe përcaktimin e kërkesave të mjaftueshme për garantimin e pakicave të drejtën për të studiuar gjuhën e tyre ose në gjuhën e tyre.</p> <p>4. VKM nga MB për përdorimin e gjuhëve të pakicave ndërmjet personave që i përkasin pakicave kombëtare dhe njesisë së qeverisjes vendore</p> <p>5. VKM për Iniciativat dhe Projektet për të mbështetur Pakicat</p>	Vendimarrje nga Institucionet qendrore	Qeveria	Dhjetor 2020

14	<b>Miratimi i Ligjit (të amenduar) të Censurit</b>	<p>1. Konsultime paralele për draftin me deputetët</p> <p>2. Konsultime me OJQ-të minoritare dhe ekspertë</p> <p>3. Komunikimi me EUD dhe Shtetet Anëtare</p> <p>4. Shqyrtimi i projektligjit në komisionet parlamentare, konsultimi me palët e interesuara dhe miratimi</p>	<p>1. Shqyrtimi i projektligjit nga Komisioni Parlamentar për Financë dhe Ekonomi</p> <p>2. Shqyrtimi i projektligjit nga Komisioni i Ligjit</p> <p>3. Konsultime me palët e interesuara</p>	Kuvendi	Tetor 2020

15	<p><b>Realizimi i reformës në fushën e të drejtës së pronës, përfshirë dhe përparimin në procesin e regjistrimit të pronave</b></p>	<p>1. Plotësim i kuadrin nënligjor të Ligjit 111/2018 "Për Kadastrën në RSH",</p> <p>2. Plotësim i kuadrin nënligjor të ligjit "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë" 20/2020</p>	<p>1 . Hartim i akteve nënligjore në zbatim të Ligjit 111/2018 dhe 20/2020:</p> <p>Të dyja këto ligje bashkarisht shoqërohen nga një korpus prej 27 VKM, nga të cilat një pjesë janë miratuar, një pjesë janë në proces miratimi dhe pjesa tjetër në proces draftimi.</p> <p>i. Projektvendim "Për modelin e kartelës së pasurisë së paluajtshme"</p> <p>ii. Projektvendim ""Për rregullat e hollësishme për përdorimin, administrimin dhe ruajtjen e bazës së të dhënave mbi pasuritë e paluajtshme"</p> <p>iii. Projektvendim "Për modelin e certifikatës së pronësisë dhe të certifikatave për të drejtat reale mbi pasuritë e paluajtshme").</p> <p>iv. Projektvendim "Për rregullat dhe procedurat për ushtrimin e së drejtës nga personat juridikë/fizikë vendas apo të huaj për të patur akses në sistemin elektronik"</p> <p>v. Projektvendim "Për rregullat për procedurën e trajtimit të kërkesave nga SHKSH"</p> <p>vi. Projektvendim "Për procedurat e hollësishme të regjistrimit të titujve të pronësisë që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen"</p> <p>vii. Projektvendim "Për rregullat e hollësishme mbi mënyrat dhe mjetet teknike-hartografike për realizimin e përmirësimit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme"</p>	<p>Qeveria; Parlamenti</p>	<p>Tetor 2020</p>
----	---	---	---	----------------------------	-------------------

			<p>iii. Projektvendim "Për regjistrimin e pemëve dhe të pasurive të tjera natyrore"(miratuar).</p> <p>ix. Projektvendim "Për miratimin e listës së tarifave të shërbimeve kadastrale" (miratuar).</p> <p>x. Projektvendim "Për elementet formale të akteve noteriale, vendimeve gjyqësore apo akteve administrative që kontrollohen për efekt regjistrimi"</p>		
--	--	--	--	--	--